

VENDIM
Nr. 67, datë 12.4.2024

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ENSCO TRADING (ALBANIA)” SHPK, PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 586/11 prot., datë 9.4.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ENSCO Trading (Albania)’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 35, datë 27.3.2024, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 450, seria T19, të shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 136, datë 6.9.2019.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.3.2024 dhe 29.3.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 8.4.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 586/9 prot., datë 29.3.2024, ERE iu drejtua shoqërisë duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacion për saktësim/plotësim të mëtejshëm. Kjo shkresë u kthye mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “Adresë e pamjaftueshme”, ndaj ERE njoftoi subjektin nëpërmjet adresës së *email*-it, në datën 5.4.2024 dhe kërkoi që shoqëria të saktësojë adresën, për të ditur vijimin e komunikimit shkresor.

- Në vijim, shoqëria, nëpërmjet *email*-it, saktësoi adresën e saj por nga ana tjetër kërkoi sqarim të mëtejshëm, në lidhje me dokumentacionin që duhet të plotësojë në vijim.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar, për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë, shqyrtimin e dokumentacionit që shoqëria duhet të dorëzojë në lidhje me këtë aplikim, si dhe duke qenë se Bordi i ERE-s duhet të shprehet brenda datës 16.4.2024 mbi këtë aplikim, në fazën aktuale ku ndodhet komunikimi me shoqërinë, koha është e pamjaftueshme, ndaj vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 450, seria T19, të shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 136, datë 6.9.2019,

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike .

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi